



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 471 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 80, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Sondazhe arkeologjike në vendbanimin Prehistorik të Vlushës", në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Ilir Gjipali, Eda Andoni, Ergys Hasa etj, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Sondazhe arkeologjike në vendbanimin Prehistorik të Vlushës", në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Ilir Gjipali, Eda Andoni, Ergys Hasa etj, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

a) Kryerja e dy sondazheve 2x2m në dy pikat e vendbanimit Vlushës, përkatësisht në Armeninë dhe Vidhëz. Thellësia e kuadrateve do të jetë në varësi të shtresës kulturore deri në thellësi 1,50m. Gërmimi do të përfundojë në daljen e shtresës sterile.

b) Proceset që do të realizohen janë:

- Vrojtimi sipërfaqësor në dy pikat e vendbanimit;
- Marrja e kampioneve për analiza laboratorike me C¹⁴, për përcaktimin e kronologjisë absolute të vendbanimit;
- Analiza të mbetjeve në mikro dhe makro të florës dhe faunës, për studimin e plotë të mjedisit.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

- c) Gjetjet arkeologjike do të depozitohen pranë Fondeve të Institutit të Arkeologjisë dhe raporti së bashku me listën do të depozitohet pranë ASHA-s.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
 4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO